

VENDIM
Nr. 415, datë 19.6.2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 730, DATË
20.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET, TARIFAT, AFATET DHE
PROCEDURËN PËR KLASIFIKIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 45, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores së miratuar me vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në pikën 1 pas fjalës “... klasifikimin ...” shtohen fjalët “... dhe kategorizimin ...”;

b) pika 4 shfuqizohet.

2. shkronja “c/1”, e pikës 2, të nenit 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c/1 “Dokument kategorizimi” është certifikata e lëshuar nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike për përmbushjen e kriterëve lidhur me llojin e strukturës akomoduese.”.

3. Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Çdo sipërmarrës turistik që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese duhet të pajiset me dokument kategorizimi, i cili është i nevojshëm për përfitimin e lehtësirave fiskale, sipas legjislacionit në fuqi. Mënyra, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese përcaktohen me rregullore të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”.

b) pika 4 shfuqizohet.

4. Në pikën 1, të nenit 5, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Kategorizimi i çdo strukture akomoduese bëhet sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 4.”.

5. Neni 7/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7/1

1. Përfashtimisht, deri në nënshkrimin e marrëveshjes me agjenci apo organizata ndërkombëtare të mirënjohura në fushën e vlerësimit të strukturave akomoduese, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni, verifikimi dhe vlerësimi i strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje, që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “Brand name”, bëhet nga ministria përgjegjëse për turizmin, me kërkesë të vetë sipërmarrësit turistik.

2. Procedura e klasifikimit për strukturat akomoduese me 4 apo 5 yje, që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “Brand name”, përcaktohet në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”.

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe